# SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

## Pasqyrat financiare individuale
## për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
## (me raportin e audituesit të pavarur bashkëlidhur)

PËRMBAJTJE


Raporti i audituesit të pavarur ..... i
Pasqyra individuale e pozicionit financiar ..... 1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ..... 2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital ..... 3
Pasqyra individuale e flukseve të parasë ..... 4

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare individuale

1. Informacion i përgjithshëm ..... 5
2. Bazat e përgatitjes ..... 6
3. Adoptimi i standardeve dhe interpretimeve të reja dhe të rishikuara ..... 6
4. Politika Kontabël të rëndësishme ..... 7
5. Përdorimi i vlerësimeve dhe i gjykimeve ..... 16
6. Menaxhimi i rrezikut financiar ..... 16
7. Menaxhimi i rrezikut të sigurimit ..... 23
8. Shënimet shpjeguese për përcaktimin e vlerës së drejtë ..... 26
9. Mjete monetare dhe ekuivalentë ..... 27
10. Depozitat bankare me afat ..... 27
11. Investimet në filiale ..... 28
12. Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të drejta të tjera ..... 28
13. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim ..... 29
14. Aktivet e risigurimit ..... 29
15. Aktive të tjera ..... 29
16. Aktive afatgjata materiale ..... 30
17. Detyrimet për humbjet dhe rregullimet e humbjeve ..... 31
18. Rezerva për primet e pafituara ..... 32
19. Detyrime të tjera ..... 32
20. Kapitali themeltar ..... 32
21. Rezervat e rrezikut të sigurimit ..... 32
22. Primet e shkruara bruto ..... 33
23. Prime të ceduara të risiguruesit ..... 33
24. Të ardhura të tjera ..... 33
25. Kostot e marrjes në sigurim ..... 33
26. Shpenzime Administrative ..... 34
27. Shpenzime të tjera sigurimi ..... 34
28. Të ardhura nga investimet ..... 34
29. Shpenzime të tatim fitimit ..... 35
30. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara ..... 35
31. Shënime shpjeguese për palët e lidhura ..... 36
32. Ngjarje pas datës së raportimit ..... 37

Skedule Suplementare (të paaudituara) .....
Marzhi i aftësisë paguese ..... i
Aktive për mbulimin e detyrimeve të sigurimit ..... ii

pwc

## *Raport i audituesit të pavarur*

Për aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të Sigal Uniqa Group Austria sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur të Sigal Uniqa Group Austria sh.a. ("Shoqëria") të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015 dhe pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur më këtë datë si dhe nga një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacion tjetër shpjegues.

### Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare individuale në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit.

### Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare individuale bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar e evidencën e auditimit rreth shumave dhe shënimeve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicionit financiar të shoqërisë më 31 dhjetor 2015, si dhe të performancës së saj financiare dhe të flukseve të parasë për vitin ushtrimor e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Regullator

Menaxhimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve në Mbulim ("anekse shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga menaxhimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare individuale. Informacioni historik financiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare individuale, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2015, përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

*PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Rr: Ibrahim Rugova, Sky Tower, kati 9/1, Tiranë, Shqipëri*
*T: +355 (4) 2242 254, F:+355 (4) 2241 639, www.pwc.com/al*

Regjistruar në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit më 15 korrik 2009 dhe me Numër Unik të identifikimit të Subjektit NUIS K91915023A

Pricewaterhouse Coopers Audit sh.p.k

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

Jonid Lamllari

Auditues Ligjor

9 qershor 2016
Tiranë, Shqipëri

| | Shënime | 31 dhjetor 2015 | 31 dhjetor 2014 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVET** | | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë | 9 | 149,481 | 109,514 |
| Depozita me afat me bankat | 10 | 2,857,213 | 2,240,279 |
| Investime në filiale | 11 | 2,040,041 | 2,040,041 |
| Llogari të arkëtueshme nga sigurimi | 12 | 336,652 | 271,895 |
| Kostot e shtyra të marrjes në sigurim | 13 | 347,757 | 248,320 |
| Aktive të risigurimit | 14 | 581,200 | 568,554 |
| Aktive të tjera | 15 | 175,258 | 153,074 |
| Aktivet afatgjata materiale | 16 | 784,850 | 816,703 |
| **TOTAL I AKTIVEVE** | | **7,272,452** | **6,448,380** |
| **DETYRIMET** | | | |
| Detyrime nga sigurimet | 17 | 1,644,244 | 1,317,275 |
| Rezerva për primet e pafituara | 18 | 1,927,686 | 1,645,400 |
| Provizione të tjera | 27 | 101,115 | 97,325 |
| Tatim fitimi I pagueshëm | 29 | 12,353 | 22,447 |
| Detyrime të tjera | 19 | 350,240 | 284,815 |
| **TOTALI I DETYRIMEVE** | | **4,035,638** | **3,367,262** |
| **KAPITALI** | | | |
| Kapitali themeltar | 20 | 2,232,909 | 2,232,909 |
| Rezerva nga konvertimi | | (1,729) | (1,729) |
| Rezerva të rrezikut të sigurimit | 21 | 262,225 | 262,225 |
| Fitime të mbajtura | | 743,409 | 587,713 |
| **TOTAL I KAPITALIT** | | **3,236,814** | **3,081,118** |
| **TOTAL I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE** | | **7,272,452** | **6,448,380** |

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar nga Drejtuesit e Shoqërisë më 23 maj 2015 dhe janë firmosur nga:

Avni Ponari
Drejtor i përgjithshëm

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
DREJTORIA E PERGJITHSHME
HEAD OFFICE

Klement Mersini
Drejtor Finance

Shënimet nga faqja 5 në 37 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

| | Shënime | 2015 | 2014 |
|---|---|---|---|
| Prime të shkruara bruto | 22 | 3,758,157 | 3,076,644 |
| Prime të ceduara në risigurim | 23 | (525,264) | (542,956) |
| Ndryshimi neto në rezervat e primeve të pafituara | 18 | (362,731) | (353,240) |
| **Të ardhura neto nga primi i sigurimit** | | **2,870,162** | **2,180,448** |
| Të ardhura të tjera | 24 | 81,074 | 101,259 |
| **Të ardhura neto** | | **2,951,236** | **2,281,707** |
| Ndryshimi në rezervat e dëmeve të sigurimit dhe risigurimit | 17 | (233,876) | (63,278) |
| Dëme të paguara | 17 | (926,601) | (714,637) |
| **Dëme të sigurimit neto** | | **(1,160,477)** | **(777,915)** |
| Kostot e marrjes në sigurim | 25 | (651,048) | (448,759) |
| Shpenzime administrative | 26 | (846,435) | (748,895) |
| Shpenzime të tjera sigurimi | 27 | (153,970) | (245,401) |
| **Fitimi/(humbja) operative** | | **139,306** | **60,737** |
| Të ardhura nga investime | 28 | 145,163 | 180,882 |
| Fitime nga kursi këmbimit | | 74,140 | 111,694 |
| **Te ardhura financiare neto** | | **219,303** | **292,576** |
| **Fitimi para tatimit** | | **358,609** | **353,313** |
| Tatimi mbi fitimin | 29 | (62,912) | (62,183) |
| **Fitimi i vitit** | | **295,696** | **290,130** |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse | | - | - |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit** | | **295,696** | **291,130** |

Shënimet nga faqja 5 në 37 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2015**

*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)*

| | Kapitali themeltar | Rezerva të rrezikut të sigurimit | Rezerva nga konvertimi | Fitime të mbartura | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Gjendja më 1 janar 2014** | **2,232,909** | **224,504** | **(1,729)** | **474,304** | **2,929,988** |
| Fitimi i vitit | - | - | - | 291,130 | 291,130 |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin** | - | - | - | **291,130** | **291,130** |
| Shpërndarja e fitimeve të mbartura | - | 37,721 | - | (37,721) | - |
| Dividendë të paguar | | | | (140,000) | **(140,000)** |
| **Gjendja më 31 dhjetor 2014** | **2,232,909** | **262,225** | **(1,729)** | **587,713** | **3,081,118** |
| Fitimi i vitit | - | - | - | 295,696 | 295,696 |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin** | - | - | - | **295,696** | **295,696** |
| Dividendë të paguar | - | | - | (140,000) | **(140,000)** |
| **Gjendja më 31 Dhjetor 2015** | **2,232,909** | **262,225** | **(1,729)** | **743,409** | **3,236,814** |

Shënimet nga faqja 5 në 37 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

| | Shënime | 2015 | 2014 |
|---|---|---|---|
| **Flukset e parasë nga aktivitetet operative** | | | |
| **Fitimi para tatimit** | | **358,609** | **353,313** |
| *Rregullime për:* | | | |
| Zhvlerësime | 16 | 66,345 | 60,759 |
| Fitimi nga shitja e aktiveve afat-gjata materiale | 16 | 1,993 | (3,960) |
| Zbritje për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme | 12 | (27,691) | 112,938 |
| Ndryshime në detyrimet për humbjet dhe shpenzimet nga rregullimet e humbjeve | 17 | (117,472) | 9,266 |
| Ndryshime në rezervat për primet e pafituara | 18 | 173,579 | 348,692 |
| Ndryshime në aktivet e risigurimit | 14 | (12,646) | 58,560 |
| Të ardhura nga interesi | | (238,336) | (40,882) |
| Të ardhura të tjera nga investimet | 28 | (99,438) | (140,000) |
| Ndryshime në llogari të arkëtueshme nga sigurimi | 12 | (22,182) | (131,009) |
| Ndryshime në kostot e shtyra të marrjes në sigurim | 13 | 326,969 | (79,926) |
| Ndryshime në aktivet e tjera | 15 | 282,285 | 25,318 |
| Ndryshime në detyrimet e tjera | 19 | 69,215 | 162,209 |
| **Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative** | | **761,229** | **735,278** |
| Tatimi fitimi i paguar | 29 | (73,006) | (13,806) |
| Interesa të marra | 24 | 25,136 | 47,539 |
| **Flukset neto të parasë nga aktivitetet operative** | | **713,359** | **769,011** |
| **Flukset monetare nga aktivitetet investuese** | | | |
| Blerje e aktiveve afat-gjata materiale | 16 | (41,064) | (151,059) |
| Të ardhura nga shitja e aktiveve afat-gjata materiale | | 4,579 | 7,958 |
| Të ardhura neto nga depozitat me afat | 11 | (614,379) | (608,423) |
| Të ardhurat nga letra me vlerë | 12 | - | - |
| Dividend të marrë | | 117,472 | 140,000 |
| **Flukset neto të parasë (të përdorura)/nga aktivitetet investuese** | | **(533,392)** | **(611,524)** |
| **Flukset monetare nga aktivitetet financuese** | | | |
| Dividend të paguar | 20 | (140,000) | (140,000) |
| **Flukset neto të parasë të përdorura në aktivitetet financuese** | | **(140,000)** | **(140,000)** |
| **Rritja/(ulja) neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre** | | **39,967** | **17,487** |
| Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit | 9 | 109,514 | 92,027 |
| **Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit** | **9** | **149,481** | **109,514** |

Shënimet nga faqja 5 në 37 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.